



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT

Nr. 2370/1 prot.

Tiranë më 29.12.2023

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

KRYEMINISTRISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 4796/4 prot., datë 21.12.2023, nëpërmjet të cilës dërgoni për mendim, projektvendimin *“Për miratimin e rregullave për administrimin e regjistrit të objekteve të konfiskuara, të dhënat parësore dhe dytësore të tij, subjektet e interesuara dhe niveli i aksesit”* së bashku me relacionin shpjegues, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe i relacionit, vërejmë se krijimi i “Regjistrit të Objekteve të Konfiskuara” bazohet në pikën 3, të nenit 14, të ligjit nr. 66/2023 *“Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”*.

Ndërkohë, sipas pikës 5 dhe 6 të projektvendimit, të dhënat ndahen në dy kategori, në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore. Sipas kësaj ndarje, evidentojmë se në projektvendim nuk është cilësuar se cilat të dhëna do të jenë publike në Regjistër dhe cilat jo.

Referuar pikës 7, të nenit 3, të ligjit të sipërcituar parashikohet se: *“7. “Regjistri i Objekteve të Konfiskuara” është regjistri publik në të cilin regjistrohen/shënohen të dhëna mbi përkatësinë, të drejtat reale, pozicioni gjeografik, përmasat dhe vlera e objekteve të konfiskuara, në kuptim të këtij ligji, vendimi i organit administrativ përgjegjës për konfiskimin e objekteve të ndërtuara pa leje/në tejkallim të lejes së ndërtimit”*.

Në këtë kuadër, në pikën 6 të projektvendimit, në të cilën parashikohen të dhënat dytësore, (si për shembull, të dhënat identifikuese për personat e tretë apo informacione të tjera plotësuese), të cilat nuk janë të cituara si publike në referencë të dispozitës së mësipërme, sugjerojmë që nga ana juaj të behët një vlerësim mbi të dhënat që do të jenë publike, në

çdo rast (të dhëna specifike dhe shteruese) duke garantuar kriteret dhe parimet për mbrojtjen e të dhënave personale (posaçërisht parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave).

Gjithashtu, duke vlerësuar se një ndër qëllimet e këtij projektvendimi është përcaktimi i rrethit të subjekteve që do të kenë akses në këtë regjistër si dhe niveli i aksesit në këtë të fundit, sugjerojmë që në pikën 10, të projektvendimit, të qartësohen/specifikohen institucionet përkatëse sipas ndarjes së nivelit të aksesit të parashikuar në këtë pikë.

Përkundrejt këtij argumentimi dhe me përmbushjen e tij, projektvendimi konsiderohet konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi